

PËRJASHTIMET SIGURIMIN NGA VJEDHJA

Sigurimi nga Vjedhja nuk mbulon dëmtimet apo humbjet që shkaktohen drejtpërdrejt apo indirekt prej:

- a. shpërdorimit, përvetësimit, falsifikimit, mashtrimit, apo veprimeve të tjera të kryera me qëllim ose nga pakujdesia e rëndë e të Siguruarit, pjestarëve të familjes ose punonjësve të tij;
- b. humbjeve të pashpjegueshme, zhdukjeve misterioze, mungesave në inventar, mungesave të shkaktuara nga gabimet kontabël ose në numërim gjatë inventarit;
- c. vjedhjes së thjeshtë, vjedhjes nga klientët, vjedhjes me mashtrim, etj.;
- d. përdorimit të dhunës fizike ose psikike për hedhjen në dorë të pasurisë së siguruar, përjashtuar tek rojet dhe në përputhje me kushtet e përmendura në nenet 4, 5 e 6 të mesiperm;
- e. manipulimit ose keqpërdorimit të pajisjeve elektronike të përpunimit të të dhënave; gjithashtu do të përjashtohen dëmet që rrjedhin nga dëmtimi i çdo lloji pajisjeje hardware e software;
- f. zjarrit, eksplozionit ose çarjes së tubacioneve të ujit, edhe nëse një gjë e tillë ndodh si rrjedhojë e vjedhjes;
- g. tërmetit, stuhive, shpërthimeve vullkanike, përmbytjeve, ndotjeve radioaktive e shpërthimit bërthamor;
- h. veprimeve luftarake të çdo lloji pavarësisht nëse është shpallur lufta ose jo (përfshirë luftën civile), pushtimit ushtarak, gjendjes së luftes, gjendjes së jashtëzakonshme, anarkisë, mosfunksionimit të shtetit (qofte edhe në pjesë të caktuara të vendit), grushteve të shtetit, terrorizmit apo sabotimit të organizuar, revoltave, kryengritjeve, grevave, trazirave popullore, turbullirave civile, eksodeve, konfiskimeve, rekuizimeve, shkatërrimeve apo dëmtimeve të kryera me urdhër të çfarëdolloj qeverie apo autoriteti shtetëror.

Nëse në rastin e një dëmi Siguruesi përdor të drejtën e tij për të mos demshpërblyer në bazë të përjashtimeve të mesipërme, i Siguruarit do të jetë përgjegjës për të provuar se dëmi që ka ndodhur nuk ishte shkakuar direkt ose indirekt në lidhje me këto përjashtime.

Siguruesi nuk mbulon dëme që shkaktohen e lehtësohen me qëllim e faj nga:

- persona që banojnë me të Siguruarin dhe zenë lokalet ose banesën ku ndodhen sendet e siguruarat ose lokalet e banesat me të cilat komunikojnë;
- vartësit e të Siguruarit;
- të ngarkuarit me mbikqyrjen e sendeve të siguruarat, lokaleve ose banesës ku ndodhen këto objekte.